

LIGJI

PËR TEKSTET MËSIMORE

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 68/2015)

I DISPOZITAT THEMELORE

Objekti i ligjit

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet përgatitja, miratimi, zgjedhja, tërheqja dhe përcjellja e teksteve mësimore dhe kompleteve të teksteve mësimore, doracakëve, materialeve mësimore dhe mjeteve shtesë mësimore për shkollat fillore dhe të mesme (në tekstin vijues: shkolla).

Në përgatitjen, miratimin, botimin dhe tërheqjen e mjeteve didaktike dhe mjeteve didaktike për lojë dhe mjetet ndihmëse për edukim parashkollor, arsimim dhe shkollën, si dhe përcjellja e tyre gjatë përdorimit në punën edukativo-arsimore, në përputhje me rrethanat, aplikohen dispozitat e këtij ligji.

Përgatitja, miratimi dhe botimi i teksteve mësimore për institucionin i cili kryen veprimtari të edukimit të lartë, rregullohet me aktin e përgjithshëm të institucionit për shkollim të lartë, në përputhje me ligjin e veçantë.

Termat e përdorura në këtë ligj të cilët janë shprehur në gjuhën gramatikore mashkullore përfshijnë gjinitë natyrore edhe mashkullore edhe femërore të individëve me të cilët kanë të bëjnë.

Teksti mësimor dhe kompleti i teksteve mësimore

Neni 2

Teksti mësimor është mjet themelor i projektuar në mënyrë didaktike, në çfarëdo forme apo mediumi, i cili përdoret në punën edukativo-arsimore në shkollë për të fituar njohuri, shkathësi, formimin e qëndrimeve mbi vlerat, stimulimin e të menduarit kritik, avancimin e njohurive funksionale dhe zhvillimin e aftësive intelektuale dhe emocionale të nxënësve dhe pjesëmarrësve, përmbajtja e të cilëve është përcaktuar me planin dhe programin mësimor edhe i cili është miratuar në përputhje me këtë ligj.

Kompleti i teksteve mësimore dhe mjetet tjera mësimore për lëndë të caktuar, respektivisht fushë mësimore apo modul (në tekstin vijues: lënda) në klasën e caktuar, kurse përmbajtja e kompletit të teksteve mësimore përcaktohet me Planin e Teksteve.

Mjeti tjetër mësimor mund të jetë pjesë përbërëse e kompletit të teksteve mësimore dhe të i kontribuoj realizimit të qëllimeve të lëndës së dhënë, të përcjell tekstin mësimor dhe përdoret për të mbizotëruar, kontrolluar dhe zgjeruar njohurit e fituara me përdorimin e teksteve mësimore dhe varësisht nga lënda dhe klasa mund të jenë:

- 1) fletorja e punës;
- 2) koleksion i detyrave;
- 3) atlasit gjeografik, atlasit historik, harta e murit dhe të ngjashme;
- 4) koleksion i teksteve, reproduksion i dokumenteve, kryevepra artistike, fotografi, ilustrime, vizatime etj.;
- 5) mbishkrim notash;
- 6) mbishkrim digjital;
- 7) praktikum për ushtrime;
- 8) audio inçizim;
- 9) inçizim audio-vizual;
- 10) material për dizajne;
- 11) fjalor për gjuhë të huaja.

Teksti mësimor dhe kompleti i teksteve mësimore (në tekstin vijues: teksti mësimor) sipas rregullës përmban shtojcë elektronike, e cili ndihmon nxënësit në mbizotërimin e pavarur, kontrollimin dhe zgjerimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve apo si stimulim për punë kreative i cili është miratuar në përputhje me këtë ligj.

Teksti mësimor në gjuhën dhe shkrimin e minoritetit kombëtar

Neni 3

Me tekst mësimor në gjuhën dhe shkrimin e minoritetit kombëtar, konsiderohet:

- 1) teksti mësimor në gjuhën dhe shkrimin e minoritetit kombëtar i cili është botuar në territorin e Republikës së Serbisë;
- 2) Teksti mësimor në gjuhën dhe shkrimin e minoritetit kombëtar i cili është përkthimi i tekstit mësimor të miratuar në gjuhën serbe;
- 3) shtojca e tekstit mësimor e cili përdoret për realizimin e pjesës së adaptuar të programit mësimor për lëndët me rëndësi për minoritetin kombëtar;
- 4) teksti mësimor në gjuhën dhe shkrimin e minoritetit kombëtar i botuar në shtetin e huaj, i cili është miratuar në përputhje me këtë ligj.

Dispozitat e këtij ligji të cilat kanë të bëjnë me tekstin mësimor, aplikohen edhe në shtojcën me tekstin mësimor për lëndët me rëndësi për minoritetin kombëtar.

Teksti mësimor me përmbajtje dhe/ose format të adaptuar

Neni 4

Nxënësit me aftësi të kufizuara përdorin tekstin mësimor përmbajtja dhe/ose formati i të cilit iu është adaptuar aftësive, nevojave dhe mundësive të tyre.

Nxënësit me invaliditet përdorin tekste mësimore formati i të cilëve respektivisht shkrimi iu është adaptuar nevojave të tyre.

Mënyrën e adaptimit të përmbajtjes dhe formatit të teksteve mësimore nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, e përcakton ministri kompetent për punë të edukimit (në tekstin vijues: ministri).

Mjeti shtesë mësimor dhe mjeti ndihmës mësimor

Neni 5

Mjeti shtesë mësimor është mjeti i dytë mësimor që kontribuon në arritjen e objektivave të lëndës së dhënë, përcjell tekstin mësimor dhe mund të përdoret për të mbizotëruar, kontrolluar dhe zgjeruar njohuritë e fituara duke përdorur tekstet dhe punën e pavarur të nxënësve dhe është përputhur me programin e lëndës, kurse nuk është përcaktuar si pjesë përbërëse e kompletit të teksteve mësimore. Mjeti shtesë mësimor mund të jetë edhe doracak për mësuesin.

Mjeti ndihmës është mjet mësimor i cili përdoret në punën edukativo-arsimore me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe me invaliditet.

Mjeti didaktik dhe mjeti didaktik për lojë

Neni 6

Mjeti didaktik dhe mjeti didaktik për lojë që përdoret në punën edukativo-arsimore në institucionin parashkollor, shkollë dhe shkolla për edukimin e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe me invaliditet janë përmbajtje të dizajnuara në mënyrë didaktike, në çfarëdo forme apo mediumi, sipas moshës së fëmijëve dhe nxënësve: libra me foto, fletushka pune, libra për fëmijë, enciklopedi, lodra, lodra muzikore, instrumente muzikore, lodra me mekanizëm për lëvizje, mjete audio-vizuale dhe lëndë tjera dhe materiale.

Doracaku dhe materiali mësimor

Neni 7

Doracaku dhe materiali mësimor paraqesin mjet mësimor, në cilëndo formë dhe medium, i cili përdoret për të arritur njohuri, aftësi, formuar qëndrime mbi vlerat dhe zhvillimin e aftësive intelektuale dhe emocionale të nxënësve dhe pjesëmarrësve, përmbajtja e të cilit e përcjell planin dhe programin mësimor edhe i cili është miratuar në përputhje me këtë ligj.

Doracaku dhe materiali mësimor mund të përdoren:

- 1) për lëndët profesionale në shkollat artistike profesionale, së bashku me tekstin mësimor apo pavarësisht, përmbajtja e të cilit mundëson që arritjet e reja në fushën shkencore, artistike, respektivisht fushën profesionale drejtpërdrejt të aplikohen në punën edukativo-arsimore;
- 2) në edukimin themelor të të rriturve për mësimdhënie, mësim të përbashkët dhe të pavarur, ushtrim dhe vetëvlerësim;

3) për edukimin e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe me invaliditet të cilët janë të përgatitur në përputhje me aftësitë, nevojat dhe mundësitë e nxënësve dhe përdoren në punën edukativo-arsimore në shkollë për mësim dhe ushtrim të përbashkët dhe të pavarur.

Plani i prokurimit të mjeteve shtesë mësimore **Neni 8**

Shkolla është e obliguar që në kuadër të Planit Vjetor të punës të parashikoj mjetet shtesë të cilat përdoren në punën edukativo-arsimore.

Vendimin mbi përdorimin e mjeteve shtesë e merr këshilli i mësuesve me propozim të justifikuar të këshillave profesionale për fushën e lëndëve.

Mjetet shtesë janë pjesë përbërëse e materialeve dhe burimit bibliotekar dhe të informimit, në përputhje me ligjin.

Financimi i teksteve mësimore me mjetet e buxhetit të Republikës së Serbisë

Neni 9

Me qëllim të ofrimit të qasjes së barabartë në arsimim dhe edukim të nxënësve dhe pjesëmarrësve nga familjet sociale/materialisht të cenuara, Qeveria mund, në përputhje me mjetet në dispozicion nga buxheti i Republikës së Serbisë të marrë vendimin mbi financimin e prokurimit dhe dhënien, respektivisht kofinancimin e prokurimit të teksteve mësimore, doracakëve dhe materialeve mësimore për vitin e ardhshëm shkollor.

Qeveria, në mënyrë që të sigurojë tekstet mësimore dhe doracakët dhe materialin mësimor për shkollat fillore në gjuhët e pakicave kombëtare dhe për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe me invaliditet, mund të vendosë për financimin ose bashkëfinancimin e përgatitjes dhe/ose blerjen dhe shpërndarjen e këtyre teksteve, doracakëve dhe materialeve mësimore të cilat botuesi publik është i detyruar ti përgatisë, në përputhje me këtë ligj.

Nëse, teksti mësimor, doracaku dhe materiali mësimor nga paragrafi 2 i këtij neni nuk miratohen, Qeveria mund të vendosë për financimin ose bashkëfinancimin e përgatitjes dhe/ose blerjen dhe shpërndarjen e këtyre teksteve, doracakëve dhe materialeve mësimore të botuesve privat për të cilët është deklaruar numri më i madh i nxënësve të gjeneratës së caktuar, të cilët botuesi privat është i detyruar ti përgadisë, në përputhje me këtë ligj.

Qeveria, me qëllim të sigurimit të qasjes në të gjitha tekstet mësimore, doracakët dhe materialet mësimore të përcaktuara me planin mësimor, mund të marr vendimin mbi financimin, respektivisht bashkëfinancimin e përgatitjes dhe/ose prokurimin dhe shpërndarjen e teksteve mësimore të cilat mungojnë, doracakëve dhe materialit mësimor për nxënësit dhe pjesëmarrësit me aftësi të kufizuara dhe me invaliditet, pjesëmarrësit e minoritetit kombëtar, si dhe për lëndët profesionale në shkollat profesionale dhe shkollat e artit.

Me vendimin nga paragrafi 1. i këtij neni Qeveria përcakton:

- 1) nivelin dhe llojin e edukimit, klasën dhe lëndën për të cilët do të financohen, respektivisht bashkë financohen tekstet mësimore, doracakët dhe materiali mësimor;
- 2) kushtet dhe kriteret në bazë të të cilëve nxënësi, respektivisht pjesëmarrësi, realizon të drejtën për financim, respektivisht bashkëfinancim.

Zgjedhja dhe prokurimi i teksteve mësimore, doracakëve dhe materialit mësimor të përcaktuar me vendimin nga paragrafi 1 i këtij neni, bëhet në përputhje me këtë ligj dhe ligjin i cili përcakton fushën e prokurimeve publike.

Përdorimi i gjuhës dhe shkrimit

Neni 10

Teksti mësimor, doracaku dhe materiali mësimor, mjete shtesë mësimor, mjete didaktik dhe mjete didaktik për lojë shtypen në gjuhën serbe dhe shkrimin çirilik.

Përrjashtimisht, doracaku dhe materiali mësimor për lëndët profesionale në shkollat profesionale dhe të artit dhe shtojca elektronike së bashku me tekstin mësimor, mund të shtypet në gjuhën serbe dhe shkrimin latin, nëse mënyra e prezantimit të përmbajtjes së programit mësimor të fushës së caktuar profesionale, për shkak të përdorimit të Sistemit Ndërkombëtar të Njësive, me qëllim të prezantimit më të mirë dhe të kuptuarit të përmbajtjes.

Teksti mësimor, doracaku dhe materiali mësimor, mjete shtesë mësimor, mjete didaktik dhe mjete didaktik për lojë do të shtypen në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare, kur puna edukativo-arsimore kryhet në atë gjuhë.

Për fëmijët, nxënësit dhe të rriturit me aftësi të kufizuara dhe me invaliditet, teksti mësimor, doracaku dhe materiali mësimor, mjete didaktik dhe mjete didaktik për lojë botohet në përputhje me nevojat dhe aftësitë e fëmijëve, nxënësve dhe pjesëmarrësve, si në gjuhën serbe ashtu dhe në gjuhën e pakicave kombëtare.

Për kryerjen e punës edukativo-arsimore me fëmijë, nxënës dhe të rritur me të parë të dëmtuar, teksti mësimor, doracaku dhe materiali mësimor, mjete didaktik dhe mjete didaktik për lojë do të botohet në shkrimin Braj, në format elektronik ose formate që janë të përshtatura (përmbajtja e tërë faqes e shtypur e rritur, fotografia e përpunuar për nevojat e nxënësve me vështirësi në të pame, zgjerime fotografike, vizatime reliefi, diagrame, harta, inçizime zëri, respektivisht formë tjetër dhe media).

Teksti mësimor i gjuhës së huaj botohet në gjuhën dhe shkrimin përkatës të huaj.

Dispozitat e këtij neni zbatohen për shtojcën elektronike.

Mundësitë e barabarta dhe ndalimi i diskriminimit

Neni 11

Teksti mësimor, doracaku dhe materiali mësimor, shtojca elektronike me tekstin mësimor, mjete ndihmës mësimor, mjete didaktik dhe mjete didaktik për lojë, me përmbajtjen dhe formën e vetë duhet të mundësojnë zbatimin e parimit të mundësive të barabarta.

Teksti mësimor, doracaku dhe materiali mësimor, shtojca elektronike me tekstin mësimor, mjete ndihmës mësimor, mjete didaktik dhe mjete didaktik për lojë me përmbajtjen e tyre apo formën nuk guxojnë të diskriminojnë apo vendosin në pozitë të pabarabartë grupet apo individët apo të nxisin sjellje të tillë, në përputhje me ligjin me të cilin rregullohet ndalimi i diskriminimit.

II BOTUESIT E TEKSTEVE MËSIMORE

Neni 12

Botimin e teksteve mësimore, doracakëve dhe materialit mësimor, mjetit shtesë mësimor, mjetit didaktik dhe mjetit didaktik për lojë mund ta bëjë ndërmarrja publike (në tekstin vijues: botuesi publik), personi tjetër juridik apo ndërmarrësi i cili ka regjistruar veprimtarinë për botim.

Botuesi publik është i detyruar të përgadisë dorëshkrimet e teksteve për të gjitha lëndët në shkollën fillore dhe mjetet didaktike për programin parashkollor përgaditor, në gjuhën serbe dhe gjuhën e pakicës kombëtare, si dhe tekstet mësimore që shtypen me përmbajtje përshtatur dhe/ose format për nxënës me aftësi të kufizuara dhe me invaliditet, me përjashtim të nxënësve në arsimin gjithëpërfshirës.

Doracakun dhe materialin mësimor për lëndët profesionale në shkollat profesionale dhe të artit mund ta botoj edhe shoqata e shkollave profesionale dhe të artit.

Doracakun dhe materialin mësimor për nxënësit dhe të rriturit me aftësi të kufizuara dhe me invaliditet mund ta botoj edhe shoqata e shkollave për nxënës me aftësi të kufizuara apo invaliditet edhe shoqata profesionale e defektologëve.

Doracakun dhe materialin mësimor për arsimimin e të rriturve mund ta botoj edhe shoqata e shkollave e cila realizon programet e arsimit fillor të të rriturve.

III PËRGADITJA E TEKSTEVE MËSIMORE

Përcaktimi i planit të teksteve mësimore

Neni 13

Me planin e teksteve mësimore rregullohen tekstet mësimore sipas lëndëve, fushave dhe niveleve të edukimit, të cilët përdoren në punën edukativo-arsimore.

Për lëndët profesionale në shkolla profesionale, për pjesëmarrësit e shkollës fillore edhe për edukimin e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe invaliditet përveç teksteve mësimore, me planin e teksteve mësimore mund të përcaktohet edhe doracakun edhe materialin mësimor.

Me planin e teksteve mësimore definohet përmbajtja e kompletit të teksteve mësimore, duke u udhëhequr me parimin që secila komponent e kompletit të teksteve mësimore është e domosdoshme për realizimin e qëllimeve të lëndës së caktuar mësimore. Secila komponentë e kompletit të teksteve mësimore ka funksion të qartë, kurse të gjitha komponentët e kompletit përbejnë një tërësi koherente.

Këshilli Kombëtar i Arsimit, me propozimin e Entit për Avancimin e Arsimit (në tekstin e mëtejshëm: Enti) miraton planin e teksteve mësimore të arsimit edhe edukimit fillor dhe të mesëm si dhe të përgjithshëm të artit, lëndët e përgjithshme të arsimit të mesëm profesional dhe arsimimit dhe edukimit të të rriturve.

Këshilli Kombëtar i Arsimit, pas marrjes së opinionit të Entit, miraton planin e teksteve mësimore për edukim fetar, me propozim të Komisionit për Arsim Fetar, i krijuar në përputhje me rregullat për arsim fillor dhe të mesëm.

Këshilli Kombëtar i Arsimit, me propozim e Entit dhe të Këshillit Kombëtar të Pakicave Kombëtare, miraton planin e teksteve mësimore në gjuhën dhe shkrimin e pakicave kombëtare dhe të teksteve shkollore për lëndët me interes të pakicave kombëtare.

Këshilli për Arsim profesional dhe edukim të të rriturve me propozimin e Entit, miraton planin e teksteve për lëndët profesionale në shkollat profesionale.

Plani i teksteve mësimore miratohet të njëjtën kohë me miratimin e programit mësimor, respektivisht kur përcaktohet nevoja për të ndryshuar planin ekzistues të teksteve mësimore.

Propozimi nga parag. 4-7. i këtij neni, Enti në të njëjtën kohë i dorëzon Këshillit Kombëtar të Arsimit respektivisht Këshillit për Arsim dhe Aftësim Profesional (në tekstin vijues: Këshilli kompetent) dhe Ministrisë.

Nëse Këshilli kompetent nuk miraton planin e teksteve brenda 45 ditëve nga paraqitja e propozimit të Entit, planin e teksteve mësimore e miraton Ministri.

Këshilli kompetent është i detyruar që për arsyet e mospërfilljes nga paragrafi 10 i këtij neni ti raportoj Asamblesë Kombëtare ose Qeverisë.

Plani i teksteve mësimore botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë – Gazetën e Arsimit" në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsim (në tekstin e mëtejme: Ministria).

Përmbajtja e planit të teksteve mësimore

Neni 14

Plani i teksteve mësimore përmban:

- 1) Titullin e librit për çdo nivel të arsimit dhe llojin e shkollës, sipas klasave dhe lëndëve;
- 2) titullin e doracakëve dhe materialeve mësimore për secilin nivel të arsimit dhe llojin e shkollës, sipas klasave dhe lëndëve;
- 3) gjuhën dhe shkrimin në të cilin shtypet teksti mësimor, respektivisht doracaku dhe materiali mësimor;
- 4) forma dhe mediumi në të cilin përdoret teksti mësimor;
- 5) Numri i rekomanduar i faqeve ose volumi i teksteve mësimore.

Standardet e kualitetit të teksteve mësimore

Neni 15

Për të arritur cilësi të lartë dhe të balancuar të edukimit dhe arsimimit, bazuar në arritjet e shkencës moderne, adaptuar nevojave psikofizike dhe personale sipas moshës të çdo fëmije, nxënësi dhe të rrituri, teksti mësimor duhet të jetë në përputhje me standardet e kualitetit të teksteve (në tekstin e mëtejme: Standardet).

Standardet paraqesin kushtet që kanë të bëjnë me përmbajtjen, kërkesat pedagogjike dhe psikologjike, përpunimin didaktik dhe metodik, kërkesat gjuhësore, përpunimin, pajisjen me grafikë dhe teknikë për tekstet mësimore, varësisht nga forma, media dhe dedikimi.

Këshilli Kombëtar i Arsimit me propozim të Entit përcakton standardet dhe udhëzimet për aplikimin e tyre për:

- 1) tekste mësimore;
- 2) shtojcë elektronike;
- 3) doracak dhe materiale mësimore;
- 4) mjete shtesë mësimore, mjet didaktik dhe mjet didaktik për lojë.

Përmbushja e Standardeve paraqet bazën për të bërë një vlerësim profesional të kualitetit të dorëshkrimeve të teksteve shkollore (në tekstin e mëtejme: vlerësimi profesional), mendimin e ekspertëve për doracakët dhe materialet mësimore, mjetin didaktik dhe mjetin didaktik për lojë dhe mendimin e ekspertit.

Lista e teksteve mësimore

Neni 16

Ministria, çdo katër vjet bënë ftesë publike për të paraqitur kërkesa për miratimin e teksteve shkollore (në tekstin e mëtejme: Ftesa Publike).

Me rastin e miratimit të planit dhe programit të ri mësimor, Ministria shpall Ftesën Publike dhe para afatit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, duke marrë parasysh kohën e nevojshme për përgatitjen e teksteve të reja, afatet për dorëzimin e aplikacioneve dhe fillimin e zbatimit të planit dhe programit të ri mësimor.

Afati për përgatitjen e teksteve shkollore në rastin e miratimit të planit dhe programit të ri mësimor nuk mund të jetë më i shkurtër se 60 ditë.

Ftesa publike përmban informacione në lidhje me titullin e teksteve sipas niveleve të edukimit, klasës dhe lëndës, numrit të rekomanduar të faqeve, respektivisht volumit të teksteve mësimore, çmimit më të lartë të shitjes me pakicë, duke përfshirë TVSH-në, mediat, gjuhën dhe shkrimin në të cilën botohet, afatin dhe mënyrën për paraqitjen e kërkesës dhe shpallet më së voni deri me 1 mars të vitit në të cilin publikohet lista e teksteve mësimore të miratuara (në tekstin e mëtejme Lista).

Të gjitha tekstet mësimore për të cilët është shpallur Ftesa Publike dhe të cilët janë miratuar në përputhje me këtë ligj, njëkohësisht pranohen në Listë.

Lista publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë, jo më vonë se deri më 31 dhjetor i vitit shkollor në të cilin publikohet katalogu i teksteve mësimore (në tekstin e mëtejme: katalogu).

Lista përmban të dhënat si ne vijim:

- 1) titullin e tekstit mësimor;

- 2) titullin e lëndës, klasën dhe llojin e shkollës për të cilën teksti mësimor është dedikuar;
- 3) emrin e autorit të tekstit mësimor;
- 4) numrin dhe datën e shpalljes së vendimit mbi miratimin e tekstit mësimor;
- 5) gjuhën dhe shkrimin në të cilin shtypet teksti mësimor;
- 6) titulli i plotë i botuesit.

Botuesi detyrohet që në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit të Listës, ti dorëzoj të gjitha administratave së paku nga një kopje të tekstit mësimor, me qëllim të sigurimit të qasjes në tekstet mësimore shkollave në procedurën e zgjedhjes.

Në rast të paragrafit 2. të këtij neni, Lista azhurohet edhe para afatit nga paragrafi 6. i këtij neni.

Përfundimisht, nëse në Ftesën Publike, asnjë botues nuk paraqet kërkesën për miratimin e teksteve mësimore për lëndët të caktuara në gjuhën serbe dhe gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare, Ministria e urdhëron botuesin publik ti përgatis tekstet mësimore që mungojnë dhe përcakton afatin në të cilin është i detyruar ta paraqes kërkesën për miratimin e tyre në gjuhën serbe, përkthimin në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare dhe botimin e përmbajtjes dhe/ose formatit i cili iu është adaptuar nxënësve me aftësi të kufizuara dhe me invaliditet.

Katalogu i teksteve mësimore

Neni 17

Ministria çdo katër vjet publikon Katalogun.

Në paraqiten tekstet mësimore nga Lista, edhe atë:

- 1) tekstet mësimore për të njëjtën temë në të njëjtën klasë që kanë zgjedhur shkollat të cilat i ndjekin të paktën 5% të nxënësve nga një gjeneratë e caktuar. Në qoftë se pas deklarimit të shkollave janë zgjedhur më shumë se gjashtë tekste mësimore me një përqindje më të lartë se 5%, në katalog paraqiten gjashtë tekste mësimore me përqindjen më të lartë. Në qoftë se pas deklarimit të shkollave janë zgjedhur më pak se tre tekste mësimore me përqindje më të madhe se 5%, në Katalog janë pranuar tre tekste mësimore me përqindjen më të lartë;
- 2) tekstet mësimore për lëndët për të cilët janë aprovuar tre apo më pak tekste mësimore, pavarësisht nga zgjedhja e shkollave;
- 3) teksti mësimor përmbajtja e të cilit iu është përshtatur nxënësve me aftësi të kufizuara dhe teksti mësimor formati i të cilit respektivisht shkrimi iu është përshtatur nxënësve me invaliditet.

Për mësimin i cili zbatohet në gjuhën e pakicës kombëtare, në Katalog paraqiten të gjitha tekstet mësimore në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare, të cilët gjenden në Listë.

Me gjeneratën e caktuar në kuptim të paragrafit 2 pikës 1) të këtij neni nënkuptohen të gjitha nxënësit në territorin e Republikës së Serbisë të cilët ndjekin mësimin nga lënda për të cilën zgjidhet teksti mësimor në vitin shkollor në të cilin publikohet Katalogu.

Ministri, në përputhje me paragrafin 2 dhe 3 të këtij neni, merr vendimin mbi tekstet mësimore të cilët do të paraqiten ne Katalog.

Katalogu publikohet më së largu deri më 20 prill të vitit shkollor në të cilin publikohet Lista, në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë dhe „Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë – Gazeta Arsimore ”.

Katalogu përmban të dhënat si në vijim:

- 1) emrin e tekstit mësimor;
- 2) emrin e lëndës, klasën dhe llojin e shkollës për të cilën teksti mësimor është dedikuar;
- 3) emrin e autorit të tekstit mësimor;
- 4) numri dhe data e publikimit të vendimit mbi miratimin e teksteve mësimore;
- 5) gjuhën dhe shkrimin në të cilin shtypet teksti mësimor;
- 6) emrin e plotë të botuesit.

Tekstet mësimore të zgjedhura dhe miratuara pas marrjes së planit dhe programit të ri mësimor, në përputhje me ligjin e ri, paraqiten në Katalog në mënyrë shtesë.

Ministria mban regjistrin elektronik, i cili përveç të dhënave nga paragrafi 7 i këtij neni, përmban dhe të dhëna mbi emrat e shkollave dhe numrin e nxënësve të cilët përdorin tekstin mësimor të zgjedhur.

I ndalohej shkollës të përdorë tekstin mësimor i cili nuk është paraqitur në Katalog.

Katalogu i teksteve mësimore dhe materialit mësimor

Neni 18

Ministria, sipas nevojës, shpallë ftesën publike për paraqitjen e kërkesave për miratimin e doracakëve dhe materialit mësimor.

Ftesa publike nga paragrafi 1. i këtij neni përmban të dhëna mbi emrin e doracakut dhe materialit mësimor, sipas niveleve të edukimit, llojit të shkollës, klasës dhe lëndës, formës, çmimit më të lartë për shtije me pakicë të doracakëve dhe materialit mësimor me TVSH, medium, gjuhë dhe shkrim në të cilin shtypet, mënyrën dhe afatin e paraqitjes së kërkesës.

Doracakët dhe materiali mësimor aprovohen në përputhje me këtë ligj dhe paraqiten në Katalog të doracakëve dhe materialeve mësimore.

Katalogu nga paragrafi 3. i këtij neni përmban:

- 1) doracakët dhe materialet mësimore për lëndë profesionale në shkolla profesionale dhe të artit;
- 2) doracak dhe materiale mësimore për edukim fillor të të rriturve;

3) doracak dhe materiale mësimore me përmbajtje të adaptuar dhe/ose format për nxënës dhe të rritur me aftësi të kufizuara dhe me invaliditet.

Katalogun na paragrafi 3 të këtij neni Ministria e shpallë dhe rregullisht e përditëson në faqen zyrtare të internetit, kurse shpallet edhe në faqen zyrtare të internetit të Entit dhe Këshillit kompetent.

Katalogu nga paragrafi 3. i këtij neni përmban të dhënat në vijim:

- 1) emrin e doracakut dhe materialit mësimor;
- 2) emrin e lëndës, klasës dhe llojit të shkollës për të cilën është dedikuar doracakut dhe materiali mësimor;
- 3) emri i autorit të doracakut dhe materialit mësimor;
- 4) numri dhe data e publikimit të vendimit mbi aprovimin a doracakut dhe materialit mësimor;
- 5) gjuha dhe shkrimi në të cilin shtypet doracakut dhe materiali mësimor;
- 6) emri i plotë i botuesit.

I ndalohej shkollës që të përdor doracakun dhe materialin mësimor i cili nuk është paraqitur në Katalog nga paragrafi 3. i këtij neni.

Lista e mjeteve shtesë mësimore, mjeteve ndihmësve mësimore, mjeteve didaktike dhe mjeteve didaktike për lojë

Neni 19

Mjetet shtesë mësimore, mjetet ndihmëse mësimore, mjetet didaktike dhe mjetet didaktike për lojë të miratuara në pajtim me këtë ligj do të përfshihen në Listën e materialeve shtesë mësimore, mjetet ndihmëse mësimore, mjetet didaktike dhe mjetet didaktike për lojë.

Tekstet mësimore që janë të paraqitura në Listë, por që nuk janë përfshirë në Katalog, me kërkesë të botuesit mund të përfshihen në Listën nga paragrafi 1 i këtij neni dhe do të përdoren vetëm si mjete shtesë mësimore.

Listën nga paragrafi 1 i këtij neni, Enti e publikon dhe përditëson rregullisht në ueb faqen e tij zyrtare.

Lista nga paragrafin 1 i këtij neni duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- 1) emrin e mjeteve shtesë mësimore, mjeteve ndihmëse mësimore, mjeteve didaktike dhe mjeteve didaktike për lojë;
- 2) emrin e lëndës, klasës dhe llojit të shkollës, respektivisht entit parashkollor për të cilin mjete shtesë mësimor, mjete ndihmës mësimor, mjete didaktik dhe mjete didaktik për lojë janë destinuar;
- 3) emrin e autorit të mjeteve shtesë, mjetin shtesë ndihmës, mjetin didaktik dhe mjetin didaktik për lojë;

- 4) numrin dhe datën e lëshimit të vendimit për miratimin mjetit shtesë mësimor, mjetit ndihmës mësimor, mjeti didaktik dhe mjetit didaktik për lojë;
- 5) gjuha dhe shkrimi në të cilin shtypet mjeti shtesë mësimor, mjeti ndihmës mësimor, mjeti didaktik dhe mjeti didaktik mësimor;
- 6) emrin e plotë të botuesit.

IV MIRATIMI I TEKSTEVE MËSIMORE, DORACAKËVE, DHE MATERIALEVE MËSIMORE, MJETEVE NDIHMËSE MËSIMORE, MJETEVE DIDAKTIKE DHE MJETEVE DIDAKTIKE PËR LOJË

Paraqitja e kërkesës për miratimin e teksteve mësimore

Neni 20

Kërkesën për miratimin e teksteve mësimore botuesi ia drejton Ministrisë në afat i cili është përcaktuar me Ftesën Publike.

Kërkesën për miratimin e teksteve mësimore, përveç në vitin shkollor në të cilin shpallet ftesa publike dhe vitin shkollor në të cilin shpallet Lista, botuesit mund ta paraqesin çdo vit në afat prej 30 ditëve, duke filluar nga 1 shtatori.

Tekstet mësimore të cilët janë miratuar në bazë të kërkesës së paraqitur nga paragrafi 2 i këtij neni, mund të përdoren si mjet shtesë mësimor në përputhje me nenin 19 paragrafin 2 të këtij ligji dhe paraqitet në Listën e teksteve mësimore të miratuar pas shpalljes së Ftesës së radhës publike, nëse plani dhe programi mësimor nuk ka ndryshuar.

Kërkesën për miratimin e teksteve mësimore në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare këshilli kombëtar i të cilit ka seli në territorin e krahinës autonome, i paraqitet organit të krahinës autonome për punë arsimore (në tekstin vijues: Sekretariati Krahinor).

Nëse me planin e teksteve mësimore për lëndën mësimore është paraparë kompleti i teksteve mësimore, botuesi gjithsesi në të njëjtën kohë bënë kërkesën për aprovimin e të gjitha komponentëve të kompletit të teksteve mësimore dhe shtojcës elektronike nëse e përmban.

Me kërkesën, botuesi paraqet në formë të shtypur dhe elektronike:

- 1) dorëshkrimin grafik dhe të teknikisht të formatizuar në pesë kopje;
- 2) elaboratin në pesë kopje;
- 3) vendimin e organit kompetent të botuesit për miratimin e dorëshkrimit të teksteve mësimore;
- 4) miratimin e botuesit që do të shtyp tekstin mësimor në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare në rastin e zgjedhjes së atij teksti mësimor;
- 5) miratimin e botuesit që në rast të zgjedhjes së atij teksti mësimor, të njëjti do të shtyp me përmbajtje të përshtatur dhe/ose format për nxënësit me aftësi të kufizuara të cilët ndjekin mësimin në shkolla nxënës me aftësi të kufizuara;

6) miratimin e botuesit që në rastin e zgjedhjes së tekstit mësimor, të njëjtin ta shtyp në format të përshtatur për nxënësit me aftësi të kufizuara;

7) miratimin e botuesit që do ti mundësoj mësuesve në edukimin inkluziv që pa kompensim të përdorin përmbajtjet e teksteve mësimore të cilët i ka zgjedhur shkolla e tyre me qëllim të përshtatjes me edukimin individual për nxënësit me aftësi të kufizuara;

8) pajtimin e botuesit që teksti mësimor i tij të përfshihet në Katalog, në pajtim me nenin 17 të këtij ligji;

9) deklaratën mbi atë se a është ndonjë nga anëtarët e Listës së vlerësuesve të dorëshkrimit të teksteve mësimore (në tekstin vijues: lista e vlerësuesve) autori i tekstit mësimor i atij botuesi, person i punësuar tek botuesi, i angazhuar apo i lidhur me punë me atë, duke përfshirë dhe forma tjera të bashkëpunimit të paguar, të mos jetë i lidhur me personin përgjegjës së botuesit, respektivisht të mos ekzistojnë kushte tjera të përshkruara me ligj për përjashtimin e tij.

Elaborati nga paragrafi 6. pika 2) i këtij neni medoemos përmban referenca dhe hulumtime të përdorura në përgatitjen e dorëshkrimit, përshkrimin e shtojcës elektronike dhe mënyrën e përcjelljes së kualitetit të teksteve mësimore.

Botuesi i cili paraqet kërkesën për miratimin e tekstit mësimor për mësim fetar, paraqet edhe opinionin pozitiv të Komisionit për mësim fetar.

Me kërkesën për aprovimin e dorëshkrimit të teksteve mësimore të shtypur në gjuhën dhe shkrimin e pjesëmarrësve të pakicës kombëtare, botuesi paraqet miratimin e mëparshëm të këshillit kombëtar të pakicës kombëtare dhe përkthimin e atij teksti mësimor në gjuhën serbe, përveç për tekstin mësimor të gjuhës amtare. Për saktësinë e përkthimit përgjegjës është botuesi.

Nëse botuesi paraqet kërkesë për miratimin e teksteve mësimore të cilët janë përfshirë në Listën e vlefshme, kurse nuk ka ardhur deri tek ndryshimi i planit dhe programit mësimor, aplikohen dispozitat e këtij ligji të cilat kanë të bëjnë me botimin e ri të teksteve mësimore, përveç dispozitave të cilat kanë të bëjnë me tekstin.

Ministria i paraqet Entit katër kopje të dorëshkrimit të tekstit mësimor në formë të shtypur dhe elektronike në afat prej 10 ditësh nga dita e skadimit të afatit për paraqitjen e dorëshkrimit të përcaktuar me Ftesën Publike.

Sekretariati krahinor paraqet Entit kompetent për punët e avancimit dhe zhvillimit të punës botuese profesionale në fushën e edukimit parashkollor, fillor dhe të mesëm dhe arsimimit në territorin e krahinës autonome (në tekstin vijues: Enti krahinor), katër kopje të dorëshkrimit të teksteve mësimore në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare dhe të elaboratit në formë të shtypur dhe elektronike në afat kohor prej 10 ditëve nga data e skadimit të afatit për dorëzimin e dorëshkrimit të përcaktuar me Ftesën Publike.

Botuesi siguron me kërkesën për miratimin e teksteve mësimore edhe materialin e dorëzuar nga paragrafi 6 i këtij neni i cili nuk përmban emrat autorëve të dorëshkrimit.

Botuesi i cili paraqet kërkesën për miratimin e përkthimi të tekstit mësimor të miratuar nga gjuha serbe në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare, dorëzon tekstin mësimor të miratuar në gjuhën serbe, përkthimin e atij teksti mësimor në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare dhe miratimin e mëparshëm të këshillit kombëtar të pakicës kombëtare. Për saktësinë e përkthimit përgjegjës është botuesi. Nëse këshilli kombëtar i pakicës kombëtare nuk i dorëzon botuesit

përgjigje në afat prej 45 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës së botuesit për dhënien e miratimit të mëparshëm do të konsiderohet se ka dhënë miratimin.

Botuesi i cili ka paraqitur kërkesën për miratim të përmbajtjes së adaptuar dhe/ose formatit të tekstit mësimor të miratuar për nxënësit me aftësi të kufizuara të cilët ndjekin shkollën për nxënës me aftësi të kufizuara, dorëzon tekstin mësimor të miratuar dhe tekstin mësimor me përmbajtje dhe/ose format të përshtatur.

Botuesi i cili paraqet kërkesën për miratimin e përmbajtjes së përshtatur dhe/ose formatit të tekstit mësimor për nxënës me invaliditet, paraqet tekstin mësimor të miratuar dhe tekstin mësimor me përmbajtje edhe/ose format të përshtatur.

Kërkesën për miratimin e tekstit mësimor nga paragrafi 14-16 të këtij neni botuesi ia drejton Ministrisë në afat prej 90 ditëve nga dita e pranimit të informacionit mbi zgjedhjen ne teksteve mësimore.

Procedura e miratimit të tekstit mësimor nga paragrafi 14-16 të këtij neni zbatohet në përputhje me dispozitat e ligjit të cilët kanë të bëjnë me botimin e ri të teksteve mësimore.

Me kërkesën botuesi paraqet edhe dëshminë mbi pagesën e tatimit për Vlerësimin profesional. Lartësinë e tatimit për Vlerësimin profesional e përcakton ministri, me propozimin e Entit.

Mjetet nga tatimet nga paragrafi 19 të këtij neni, janë të hyra të buxhetit të Republikës së Serbisë dhe paguhen në llogarinë e përcaktuar për pagesën e të hyrave publike.

Lista e vlerësuesve të dorëshkrimit të teksteve mësimore

Neni 21

Zgjedhjen e personave përgjegjës për edukim të përshtatur dhe kompetenca të cilët do të marrin pjesë në vlerësimin e kualitetit të dorëshkrimit të teksteve mësimore e bënë Ministri, në bazë të ftesës publike, kurse me propozimin e komisionit të veçantë për zgjedhjen e Listës së Vlerësuesve.

Ministri e emëron komisionin e veçantë për zgjedhjen e Listës së Vlerësuesve, i cili numëron 11 anëtar edhe atë: tre anëtar të cilët i propozon Këshilli Nacional për Arsim, një anëtar e propozon Këshilli për Edukim Profesional dhe Edukim e të Rriturve, dy anëtar të cilët i propozon Enti, një anëtar të cilin e propozon Enti Krahinor, një anëtarë të cilin e propozon Sekretariati Krahinor dhe tre anëtarë të cilët i propozon Ministria. Anëtarët e komisionit të veçantë për zgjedhjen e Listës së vlerësuesve mund të jenë profesionist nga fusha e edukimit dhe arsimimit.

Në bazë të zgjedhjes nga paragrafi 1 i këtij neni ministri formon Listën e Vlerësuesve.

Lista e Vlerësuesve shpallet në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë, dhe përmban:

- 1) emrin dhe mbiemrin e vlerësuesve;
- 2) shkallën edhe llojin e vlerësuesve;
- 3) biografinë profesionale (eksperiencën e punës në profesion, të dhënat mbi punët profesionale dhe pjesëmarrjen në punët profesionale në projekte/mbledhje në fushën e edukimit dhe arsimimit);

4) nivelin dhe llojin e edukimit dhe lënën për të cilën është zgjedhur si vlerësues.

Anëtarët e Listës së Vlerësuesve nuk mund të jenë personat të cilët janë edhe autor të teksteve mësimore për shkolla fillore dhe të mesme, si dhe persona të punësuar apo të lidhur me punë me botuesin e teksteve mësimore, duke përfshirë edhe format tjera të bashkëpunimit të paguar, respektivisht nuk mund të ekzistojnë kushte tjera të përcaktuara me ligj për përjashtimin etyre, për të cilën paraqesin deklaratën.

Në Listën e vlerësuesve emërohen personat me:

1) me edukim të lartë, të cilët posedojnë kompetenca nga lënda e caktuar respektivisht fusha profesionale;

2) me edukim të lartë të përshtatur të cilët posedojnë kompetenca nga metodika e profesionit/të lëndës së caktuar/të fushës së caktuar;

3) edukim të përshtatur i cili kryen punë edukativo-arsimore nga lënda e caktuar, respektivisht fushës profesionale (mësuesi);

4) edukim të përshtatur, i cili posedon kompetenca në përputhje me nevojat specifike të lëndës së caktuar, fushës profesionale respektivisht nivelin edukimit, llojit të teksteve mësimore, moshës, nevojave dhe mundësive të fëmijëve, nxënësve dhe të rriturve (psikolog, defektolog, andragog, ekspert për teknologji informative dhe të komunikimit, linguist për gjuhë të huaj dhe gjuhë të pakicës kombëtare dhe ngjashëm).

Anëtarët e Listës së Vlerësuesve duhet të kenë së paku dy vjet eksperiencë pune në profesion.

Enti nga anëtarët e Listës së Vlerësuesve formon Komisionin për Vlerësimin e Dorëshkrimit të teksteve mësimore (në tekstin vijues: Komisioni), për secilën lëndë sipas niveleve dhe llojit të edukimit.

Në Komision emërohen së paku nga një anëtar nga paragrafi 6. pika 1)-3) të këtij neni dhe së paku një anëtarë i cili është i punësuar në Ent, respektivisht Sekretariat Krahinor.

Në Komision, sipas nevojës mund të emërohen edhe personat nga paragrafi 6 pika 4) i këtij neni.

Në Komision i cili vlerëson dorëshkrimet e teksteve mësimore të cilët shtypen me përmbajtje të përshtatur edhe/ose format për nxënës me aftësi të kufizuara dhe invaliditet, emërohet defektologu, kurse në Komisionin e cila vlerëson dorëshkrimet e nxënësve të cikliti të parë të edukimit fillor dhe arsimit, psikolog.

Në Komisionin i cili vlerëson dorëshkrimet e teksteve mësimore në gjuhen dhe shkrimin e pakicës kombëtare, emërohet eksperti për gjuhën e caktuar dhe shkrimin e pakicës kombëtare.

Në Komision i cili vlerëson dorëshkrimin e teksteve mësimore i cili ka shtojcë elektronike emërohet edhe eksperti për teknologji informative dhe të komunikacionit.

Ministria kujdeset për përfaqësinë e mjaftueshme të vlerësuesve për të gjitha lëndët në të gjitha nivelet e edukimit dhe sipas nevojës shpallë ftesën publike për të plotësuar Listën e Vlerësuesve.

Mënyrën dhe procedurën e zgjedhjes së Listës së Vlerësuesve, programin e trajnimit të vlerësuesve, kodeksin etik të personave të cilët marrin pjesë në procedurën e miratimit të teksteve mësimore dhe procedurën e emërimit të anëtarëve të Komisionit, e përcakton ministri.

Vlerësimi profesional

Neni 22

Komisioni jep vlerësimin profesional, i cili përmban ftesën për përmbushjen e standardeve të përcaktuara nga neni 15. paragrafi 3. e këtij ligji.

Enti ia dorëzon Komisionit dorëshkrimet e tekstit mësimor nga neni 20. paragrafi 11. e këtij ligji në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të dorëshkrimit të tekstit mësimor.

Komisioni jep Vlerësimin profesional me sqarime dhe ia dorëzon Entit në afat prej 90 ditëve nga dita e pranimit të dorëshkrimit të tekstit mësimor.

Komisioni, para aprovimit të Vlerësimit profesional, mund t'ia kthejë një herë botuesit dorëshkrimin e tekstit mësimor për përpunim, për shkak të korrigjimit të mangësive të vogla, me sqarim të detajuar të mangësive të vëzhguara.

Botuesi është i obliguar që të korrigjojë mangësitë dhe dorëshkrimin e korrigjuar në këtë mënyrë, në formën elektronike dhe të shtypur në pesë kopje t'ia kthejë Komisionit në afat prej tetë ditëve nga dita e pranimit të dorëshkrimit, me ç'rast ky afat llogaritet në afat nga paragrafi 3. e këtij neni.

Në qoftë se botuesi nuk e dorëzon dorëshkrimin e përmirësuar të tekstit në afat nga paragrafi 5. e këtij ligji, konsiderohet se ka hequr dorë nga kërkesa për aprovimin e dorëshkrimit të tekstit, për çka Enti e lajmëron Ministrinë.

Enti në bazë të Vlerësimit profesional të arsyetuar jep propozim që të pranohet ose të refuzohet kërkesa për aprovimin e dorëshkrimit të tekstit.

Propozimin nga paragrafi 7. e këtij ligji, bashkë me Vlerësimin profesional të arsyetuar, si dhe mostrën e dorëshkrimit të korrigjuar nga paragrafi 5. e këtij ligji, Enti ia dorëzon Ministrisë dhe botuesit më së voni në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të Vlerësimit profesional.

Të gjitha Vlerësimet profesionale publikohen në ueb faqen zyrtare të Entit, njëkohësisht me publikimin e Listës.

Në qoftë se Enti nuk ia jep Ministrisë propozimin nga paragrafi 7. e këtij ligji, ministri në afat prej tetë ditëve nga dita e skadimit të afatit për paraqitjen e propozimeve, do të kërkojë nga Enti që në afat prej tri ditëve nga dita e pranimit të kërkesës të dorëzojë Vlerësimin profesional.

Vlerësimin profesional nga paragrafi 10. e këtij ligji ministri ia dorëzon botuesit në afat prej tri ditëve nga dita e pranimit. Ministri në bazë të Vlerësimit profesional, kurse pa propozim të Entit merr vendim me anë të cilit lejohet teksti mësimor respektivisht refuzohet kërkesa për aprovimin e dorëshkrimit të tekstit mësimor.

Botuesi ia dorëzon Ministrisë emrat e autorëve në afat prej tri ditëve nga dita e pranimit të Vlerësimit profesional, kurse në qoftë se botuesi ka bërë kërkesë për ekspertizë të dorëshkrimit të tekstit mësimor, në afat prej tri ditëve nga dita e pranimit të mendimit të ekspertit.

Botuesi e ka të ndaluar të kontaktojë dhe të bëjë presion te anëtarët e Komisionit gjatë procedurës së dhënies së Vlerësimit profesional.

Mënyrën dhe procedurën e dhënies së Vlerësimit profesional e përcakton ministri.

Paraqitja e kërkesës për aprovimin e dorëshkrimeve të udhëzuesve dhe materialeve mësimore, shtojcave të mjeteve mësimore, ndihmesave mësimore, mjeteve didaktike dhe mjeteve didaktike për lojë

Neni 23

Kërkesën për aprovimin e dorëshkrimit të udhëzuesve dhe materialeve mësimore botuesi ia dorëzon Ministrisë, respektivisht Sekretariatit krahinor.

Kërkesa për aprovimin e mjeteve mësimore shtesë, ndihmesave mësimore, mjeteve didaktike dhe mjeteve didaktike për lojë, botuesi ia dorëzon Entit, respektivisht Entit krahinor.

Me kërkesë nga parag. 1. dhe 2. të këtij ligji botuesi dorëzon anekset në përputhje me dispozitat e nenit 20. të këtij ligji.

Kërkesa nga paragrafi 1. e këtij neni dorëzohet në bazë të konkursit nga neni 18. paragrafi 1. e këtij ligji, kurse kur ekziston nevoja për harmonizimin e doracakut dhe mjeteve mësimore me arritjet e reja shkencore, teknike dhe teknologjike nga fusha e lëndës, kërkesa dorëzohet më së voni deri më 15 maj të vitit aktual për vitin e ardhshëm shkollor.

Kërkesa nga paragrafi 2 e këtij ligji dorëzohet një herë në vit në afat prej 30 ditëve, duke filluar nga 1 shtatori i vitit aktual për vitin e ardhshëm shkollor.

Ministria respektivisht Sekretariati krahinor i dorëzon Entit, respektivisht Entit krahinor katër kopje të dorëshkrimit të doracakut dhe të mjeteve mësimore në formë të shtypur dhe elektronike në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit.

Në bazë të kërkesës, botuesi dorëzon dëshmi për tatimin e paguar për mendimin profesional. Lartësinë e tatimit për mendimin profesional e përcakton ministri, me propozim të Entit.

Mjetet nga taksat nga paragrafi 7. e këtij ligji janë të hyra të buxhetit të Republikës së Serbisë dhe paguhet në llogarinë e caktuar për pagesën e të hyrave publike.

Procedura e aprovimit të doracakëve dhe mjeteve mësimore, mjeteve mësimore shtesë, mjeteve didaktike dhe mjeteve didaktike për lojë

Neni 24

Mendimin profesional për kualitetin e dorëshkrimit të doracakëve dhe mjeteve mësimore e jep komisioni të cilin nga radhët e të punësuarve e formon Enti, respektivisht Enti Krahinor.

Mendimin profesional për kualitetin e mjeteve mësimore shtesë, ndihmesave mësimore, mjeteve didaktike dhe mjeteve didaktike për lojë e jep komisioni nga radhët e të punësuarve e formon Enti, respektivisht Enti krahinor.

Ne qoftë se në Entin, respektivisht Entin Krahinor nuk janë punësuar persona me arsimim të përshtatshëm, mund të angazhohen persona nga Lista e Vlerësuesve.

Mendimin profesional nga paragrafi 1. e këtij neni, me propozim që dorëshkrimi i doracakëve dhe materialit mësimor të lejohet ose mos të lejohet, Enti, respektivisht Enti Krahinor ia dorëzon Ministrisë, respektivisht Sekretariatit Krahinor dhe botuesit në afat prej 45 ditëve nga dita e pranimi të dorëshkrimit.

Në bazë të mendimit profesional nga paragrafi 2. e këtij ligji, Enti, respektivisht Enti Krahinor lejon mjetet mësimore shtesë, mjetet didaktike dhe mjetet didaktike për lojë në afat prej 45 ditëve nga dita e pranimi të dorëshkrimit.

Mënyrën dhe procedurën e dhënies së mendimit profesional nga parag. 1. dhe 2. të këtij ligji e përcakton ministri.

Ekspertiza e dorëshkrimit të tekstit mësimor

Neni 25

Botuesi i cili nuk pajtohet me Vlerësimin profesional, mundet në afat prej tetë ditëve nga dita e pranimi të Vlerësimit profesional t'ia dorëzojë Ministrisë kërkesën për ekspertizën e dorëshkrimit të teksteve mësimore.

Kërkesën nga paragrafi 1. e këtij neni Ministria ia dorëzon Këshillit të autorizuar në afat prej tetë ditëve nga dita e pranimi.

Këshilli i autorizuar formon komisionin profesional me anëtarë nga Lista e vlerësuesve, të cilët nuk kanë qenë anëtarë të Komisionit për tekstin mësimor për të cilin është dorëzuar kërkesa për ekspertizë, me ç' rast siguron informacion nga Enti.

Komisioni profesional nga paragrafi 3. e këtij ligji kryen ekspertizën e dorëshkrimeve në bazë të Standardit dhe jep mendim të arsyetuar të ekspertit në formë të shkruar, të cilin Këshilli i autorizuar në afat prej 45 ditëve nga dita e pranimi të kërkesës nga paragrafi 21. e këtij neni ia dorëzon Ministrisë.

Në procedurën e ekspertizës së dorëshkrimit të doracakëve dhe mjeteve mësimore në përputhje aplikohen dispozitat e këtij neni.

Shpenzimet e ekspertizës së dorëshkrimit të tekstit mësimor i bart botuesi.

Procedura e ekspertizës së dorëshkrimit të tekstit mësimor zbatohet në përputhje me dispozitat e aktit nënligjor nga neni 22. paragrafi 14. e këtij ligji.

I ndalohet botuesit që të kontaktojë dhe të kryejë ndikim te anëtarët e komisionit profesional nga paragrafi 3. e këtij ligji gjatë procedurës së dhënies së mendimit të ekspertit.

Lartësinë e taksës për shpenzimet e ekspertizës së dorëshkrimit të tekstit mësimor e përcakton ministri.

Mjetet nga taksat nga paragrafi 9. e këtij neni, janë të hyra të buxhetit të Republikës së Serbisë dhe paguhet në llogari të përcaktuar për pagesën e të hyrave publike.

Konflikt interesi

Neni 26

Në procedurën e aprovimit të dorëshkrimit të teksteve mësimore, doracakëve dhe mjeteve mësimore, mjeteve mësimore shtesë, ndihmesave mësimore, mjeteve didaktike për lojë, personi i cili merr pjesë në procedurën e dhënies së Vlerësimit profesional, mendimit profesional, respektivisht mendimit të ekspertit, para fillimit të punës nënshkruan deklaratën që nuk është autor i teksteve mësimore për shkolla fillore dhe të mesme, që nuk është i punësuar te botuesi i teksteve mësimore, i angazhuar ose i lidhur me atë me anë të biznesit, duke përfshirë edhe forma të tjera të bashkëpunimit të pagueshëm, të mos jetë i lidhur me personin përgjegjës të botuesit, respektivisht të mos ekzistojnë kushte të tjera të përcaktuara për përjashtimin e tij.

Person përgjegjës i botuesit nga paragrafi 1. e këtij neni konsiderohet personi i autorizuar për përfaqësim dhe redaktori.

Respektimi i kushteve nga paragrafi 1. Ekzistimi i kushteve nga paragrafi 1. i këtij neni përcaktohet sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të organit shtetëror ose personave fizik:

- 1) ministri gjatë formimit të Listës së vlerësuesve, në bazë të deklaratës nga neni 21. paragrafi 5. e këtij ligji;
- 2) Enti gjatë formimit të Komisionit, në bazë të deklaratës nga neni 21. paragrafi 5. e këtij ligji dhe deklaratës nga paragrafi 1. e këtij ligji;
- 3) Enti dhe Këshilli kompetent gjatë formimit të komisionit profesional për ekspertizë, në bazë të deklaratës nga neni 21. paragrafi 5. e këtij ligji dhe deklarata nga paragrafi 1. e këtij neni.

Në qoftë se vërtetohet se anëtari i Listës së Vlerësuesve, i cili ka marrë pjesë në procedurën e dhënies së vlerësimit profesional, mendimit profesional, respektivisht mendimit të ekspertëve, ka dhënë deklaratë të pasaktë nga neni 21. Paragrafi 5. e këtij ligji dhe paragrafi 1. e këtij neni, anulohet nga lista e vlerësuesve dhe nuk mund të emërohet përsëri.

Kompetenca për aprovimin e teksteve mësimore

Neni 27

Ministri aprovon tekstin mësimor me propozim të Entit, respektivisht në bazë të mendimit të ekspertit në qoftë se është zbatuar procedura e ekspertizës.

Ministri aprovon tekstin mësimor për mësim fetar, me propozim të Entit dhe në bazë të mendimit pozitiv të Komisionit për Mësim Fetar, respektivisht në bazë të mendimit të ekspertit në qoftë se është zbatuar procedura e ekspertizës.

Ministri aprovon tekstin mësimor në gjuhën dhe shkrimin e pakicës nacionale, me propozim të Entit dhe në bazë të pëlqimit paraprak të këshillit nacional të pakicave, respektivisht në bazë të mendimit të ekspertit, në qoftë se është zbatuar procedura e ekspertizës.

Kompetenca për aprovimin e doracakëve dhe materialeve mësimore, mjeteve mësimore shtesë, ndihmesave mësimore, mjeteve didaktike dhe mjeteve didaktike për lojë

Neni 28

Ministri aprovon doracakët dhe mjetet mësimore, me propozim të Entit.

Enti aprovon mjetet mësimore shtesë, ndihmesat mësimore, mjetet didaktike dhe mjetet didaktike për lojë.

Kompetencën për aprovimin e teksteve mësimore, doracakëve dhe mjeteve mësimore, mjeteve mësimore shtesë, ndihmesave mësimore, mjeteve didaktike dhe mjeteve didaktike për lojë në gjuhën dhe shkrimin e pakicës nacionale në territorin e krahinës autonome.

Neni 29

Sekretariati krahinor aprovon tekstin mësimor, doracakun dhe materialin mësimor në gjuhën dhe shkrimin e pakicës nacionale këshilli nacional i pakicës së të cilës ka vendbanim në territorin e saj, me propozim të Entit krahinor, respektivisht në bazë të mendimit të ekspertit në qoftë se është zbatuar procedura e ekspertizës, në bazë të pëlqimit paraprak të këshillit nacional të pakicës, edhe atë:

- 1) teksti mësimor, doracaku dhe materiali mësimor në gjuhën dhe shkrimin e pakicës nacionale i cili është lëshuar në territorin e Republikës së Serbisë;
- 2) shtojca me tekstin mësimor që përdoret për realizimin e pjesës së përshtatur të programit mësimor për lëndë me rëndësi për pakicën nacionale;
- 3) teksti mësimor në gjuhën dhe shkrimin e pakicës nacionale që është përkthim i tekstit mësimor të aprovuar në gjuhën serbe;
- 4) teksti mësimor në gjuhën dhe shkrimin e pakicës nacionale e lëshuar në shtet të huaj.

Enti krahinor aprovon mjetet mësimore shtesë, ndihmesat mësimore, mjetet didaktike dhe mjetet didaktike për lojë në gjuhën dhe shkrimin e pakicës nacionale këshilli nacional i pakicës së të cilit ka selinë në territorin e krahinës autonome.

Procedura nga paragrafi 1. e këtij neni zbatohet me dispozitat e nenit 22. të këtij ligji.

Procedura nga paragrafi 2. e këtij ligji zbatohet në përputhje me aktin nga neni 24. paragrafi 45. e këtij ligji.

Sekretariati krahinor në afat prej tetë ditëve nga dita e marrjes së vendimit për aprovimin e teksteve mësimore, doracakëve dhe materialit mësimor i dorëzon Ministrit njoftimin për tekstet e lejuara mësimore, doracakëve dhe materialin mësimor nga paragrafi 1. e këtij ligji.

Enti krahinor në afat prej tetë ditëve nga dita e marrjes së vendimit për aprovimin e mjeteve mësimore shtesë, mjeteve mësimore, mjeteve didaktike dhe mjeteve didaktike për lojë i dorëzon Entit njoftim për mjetet mësimore shtesë të aprovuara, ndihmesat mësimore, mjetet didaktike dhe mjetet didaktike për lojë nga paragrafi 2. e këtij neni.

Tekstet mësimore, doracakët dhe materialin mësimor nga alineja 1. e këtij neni Ministria e inkuadron në Listë, respektivisht në katalogun nga neni 18. i këtij ligji.

Mjetet mësimore shtesë, ndihmesat mësimore, mjetet didaktike dhe mjetet didaktike për lojë në gjuhën dhe shkrimin e pakicës nacionale nga alineja 2. e këtij ligji Enti e inkuadron në listën nga neni 19. i këtij ligji.

Përmbajtja e vendimit për aprovimin e teksteve mësimore

Neni 30

Ministri, respektivisht Sekretariati Krahinor merr vendim për aprovimin e teksteve mësimore në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të propozimit nga neni 22. alineja 7. e këtij ligji, respektivisht mendimit të ekspertit nga neni 25. alineja 4. e këtij ligji.

Vendimi nga alineja 1. e këtij neni përmban:

- 1) titullin e tekstit mësimor;
- 2) emrin e lëndës, si dhe klasën dhe llojin e shkollës së cilës iu është dedikuar teksti mësimor;
- 3) emri i autorit;
- 4) gjuha dhe shkrimi në të cilin shtypet teksti mësimor;
- 5) emri i plotë i botuesit;
- 6) ftesa për vlerësim profesional të arsyetuar të cilin e ka dhënë Komisioni, respektivisht propozimi i Entit, respektivisht Entit Krahinor që të aprovohet dorëshkrimi i tekstit mësimor.

Në qoftë se botuesi ka bërë kërkesë për ekspertizën e dorëshkrimit të tekstit mësimor, vendimi përmban edhe ftesën për mendim të ekspertit, që dorëzohet e bashkangjitur vendimin nga paragrafi 1. e këtij neni dhe përbën pjesën e tij përbërëse.

Vendimi nga alineja 1. e këtij neni përfundimisht është në procedurë administrative.

Enti, respektivisht Enti Krahinor merr vendim për aprovimin e përkthimit të tekstit mësimor nga gjuha serbe në gjuhën dhe shkrimin e pakicës nacionale, përshtatshmërisë së përmbajtjes dhe/ose formatit të tekstit mësimor të aprovuar, doracakëve dhe materialit mësimor, mjeteve mësimore shtesë, ndihmesave mësimore, mjeteve didaktike dhe mjeteve didaktike për lojë, sipas dispozitave të këtij ligji.

Përmbajtja e vendimit mbi refuzimin e kërkesës për miratimin e dorëshkrimit të teksteve mësimore

Neni 31

Ministri, respektivisht Sekretariati Krahinor, merr vendimin për refuzimin e kërkesës për miratimin e dorëshkrimit të teksteve mësimore edhe pas skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për ekspertizë nga neni 25 paragrafi 1, respektivisht në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të opinionit profesional.

Vendimi nga paragrafi 1. i këtij neni përmban:

- 1) emrin e dorëshkrimit të tekstit mësimor;
- 2) emrin e lëndës, si dhe klasën dhe llojin e shkollës për të cilin dorëshkrimi i teksteve mësimor është përgatitur;
- 3) emri i autorit;

- 4) gjuha dhe shkrimi në të cilin dorëshkrimi i tekstit mësimor është përgatitur;
- 5) emri i plotë i botuesit;
- 6) ftesë për Vlerësim profesional të justifikuar të cilin e kërkon Komisioni, respektivisht propozim i Entit, respektivisht Entit Krahinor që dorëshkrimi i tekstit mësimor të mos miratohet.

Nëse botuesi ka bërë kërkesën për ekspertizë të teksteve mësimore, vendimi përmban ftesën për opinion profesional, i cili i dorëzohet bashkangjitur vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni edhe është pjesë përbërëse e tij.

Vendimi nga paragrafi 1 i këtij neni më në fund është në procedurë administrative.

Enti, respektivisht Enti Krahinor, merr vendimin mbi refuzimin e kërkesës për miratimin e përkthimit të tekstit mësimor të zgjedhur nga gjuha serbe në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare, përshtatjen e përmbajtjes dhe/ose formatit të tekstit mësimor të miratuar, dorëshkrimit të doracakut dhe materialit mësimor, respektivisht mjeteve shtesë, mjeteve shtesë mësimore, mjeteve shtesë ndihmësve didaktike dhe mjeteve didaktike për lojë, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Ndalimi i procedurës së aprovimit të teksteve mësimore

Neni 32

Nëse gjatë procedurës për aprovimin e teksteve mësimore me vendim ligjor vërtetohet se është shkelur e drejta autoriale, ministri merr vendim për ndalimin e procedurës, dhe nëse teksti mësimor është aprovuar, tërhiqet nga përdorimi në fund të vitit shkollor në të cilin merret vendimi mbi tërheqjen e tekstit mësimor.

Nëse me anë të procedurës gjyqësore apo tjetër merret vendimi me të cilin caktohet masa e përkohshme e ndalimit të lëshimit dhe përdorimit të tekstit mësimor, ministri merr vendim mbi pushimin e procedurës, dhe nëse teksti mësimor është aprovuar tërhiqet nga përdorimi në fund të vitit shkollor në të cilin merret vendimi mbi tërheqjen e tekstit mësimor.

Vendimi, gjegjësisht konkluzioni nga parag. 1 dhe 2 i këtij neni janë përfundimtar në procedurën administrative.

V ZGJEDHJA, ÇAKTIMI I ÇMIMIT MË TË MADH TË SHITJES ME PAKICË ME TVSH DHE MONITORIMI I TEKSTEVE MËSIMORE

Zgjedhja e teksteve mësimore

Neni 33

Shkolla nga lista zgjedh së paku tri tekste mësimore për secilën lëndë në secilën klasë, të cilat i rradhitë sipas prioritetit në listë të posaçme, e cila është pjesë përbërëse e vendimit mbi zgjedhjen e teksteve mësimore, mbi të cilën e njofton Këshillin e prindërve.

Nëse në Listë gjenden tri apo më pak tekste mësimore shkolla e zgjedh një tekst.

Vendimin mbi zgjedhjen e teksteve mësimore e merr këshilli i arsimtarëve nën propozimin e arsyetuar të këshilleve profesionale për fushën e lëndës, gjegjësisht aktivave profesionale të arsimtarëve të mësimit klasor.

Vendimin mbi zgjedhjen e teksteve mësimore në gjuhën e pakicës kombëtare e merr këshilli i arsimtarëve nën propozimin e arsyetuar të këshilleve profesionale për fushën e lëndës, gjegjësisht aktivave profesionale të arsimtarëve të mësimit klasor të cilët e zhvillojnë mësimin në gjuhën e pakicës kombëtare.

Vendimin mbi zgjedhjen e teksteve mësimore me përmbajtje dhe/apo format të përshtatur e merr këshilli i arsimtarëve nën propozimin e arsyetuar të këshilleve profesionale për fushën e lëndës, gjegjësisht aktivave profesionale të arsimtarëve të mësimit klasor.

Nxënësit me pengesa në zhvillim dhe invaliditet në arsimimin inkluziv, përdorin tekstet mësimore të cilat i ka zgjedhur shkolla në pajtim me vendimin nga paragrafi 2-4 i këtij neni.

Në të gjitha paralelet e klasës së njëjtë të shkollës së njëjtë, për lëndën e njëjtë mësimore sipas rregullës përdoret teksti mësimor i njëjtë i një botuesi.

Vendimin nga paragrafi 3-5 i këtij neni shkolla ia dërgon Ministrisë më së voni deri më 20 mars të vitit në të cilin publikohet Katalogu.

Nëse teksti mësimor të cilin e ka zgjedhur shkolla nuk publikohet në Katalog, shkolla është e detyruar që brenda afatit prej pesë ditëve nga dita e publikimit të Katalogut të zgjedhë tekstin tjetër nga lista nga paragrafi 1 i këtij neni, i cili është përfshirë në Katalog, gjegjësisht tekstin tjetër nga Katalogu nëse asnjë tekst nga lista nga paragrafi 1 i këtij neni nuk është përfshirë në Katalog, dhe për këtë ta njoftojë Ministrinë.

Nëse në listë nuk ka tekste mësimore të aprovuara për mësim në gjuhën e pakicës kombëtare, gjegjësisht tekste mësimore me përmbajtje dhe/apo format të përshtatur, botuesi teksti i të cilit ka përqindje më të lartë në Katalog, është i detyruar që atë tekst mësimor ta përkthejë në gjuhën adekuate të pakicës kombëtare, gjegjësisht të sigurojë tekst mësimor me përmbajtje dhe/apo format të përshtatur.

Nëse shkolla nuk e dorëzon vendimin mbi zgjedhjen e teksteve mësimore, Ministria brenda afatit prej pesë ditëve të punës nga dita e skadimit të afatit nga parag 8 dhe 9 i këtij neni, do të marrë vendim që në shkollë të përdoren tekstet nga Katalogu të cilat janë më të përfaqësuar në territorin e administratës shkollore përgjegjëse.

Vendimin final mbi tekstet mësimore të cilët do të përdoren në shkollë në katër vitet e ardhshme shkollore, shkolla e publikon në tabelën e shpalljeve dhe është e obligueshme për të gjithë ata të cilët zhvillojnë punën arsimoro-edukative.

Të dhënat mbi tekstet mësimore nga vendimi nga paragrafi 12 i këtij neni shkolla i futë në regjistrin elektronik të teksteve mësimore, në pajtim me nenin 17 paragrafi 9 i këtij ligji.

Listën e teksteve mësimore të zgjedhura, bashkë me propozimin e arsyetuar, shkolla e ruan gjithmonë në dokumentacion, në pajtim me ligjin.

Arsimtari bën shkelje të rëndë të detyrës punuese nëse nga nxënësit kërkon që të blejnë mjete mësimore shtesë.

Ndërmjetësimi i shkollës dhe të punësuarve në shitjen e teksteve mësimore me kompensim, nuk është i lejuar dhe sanksionohet ne pajtim me ligjin.

Shkolla, në pajtim me Këshillin e prindërve, mundët pa kompensim, të ndihmojë në sigurimin e të gjitha teksteve të zgjedhura, nëse në atë mënyrë prindërve i lehtësohet sigurimi i teksteve të nevojshme.

Botuesit i ndalohet që t'i japë, kurse entit parashkollor, shkollës dhe të punësuarit që të marrë ndonjë donacion, dhuratë apo përfaqësim, të bërë në mënyrë indirekte apo direkte, në çfarëdo shume apo forme.

Me donacion, dhuratë apo përfaqësim nga paragrafi 4 i këtij neni nuk konsiderohet paraqitja e tekstit mësimor në kohëzgjatje prej më së shumti një dite, e cila duhet të realizohet në hapësirat e shkollës, përfaqësimi të vlerës së vogël (laps, kalendarë, blloqe për të shkruar), si dhe shembuj falas të teksteve mësimore të cilat botuesi i jep shkollës me qëllim të realizimit të zgjedhjes së teksteve mësimore.

Caktimi i çmimit më të lartë të shitjes me pakicë të teksteve mësimore, doracakëve dhe materialeve me TVSH

Neni 35

Ministri, në bazë të propozimit të Komisionit për caktimin e çmimit më të lartë të shitjes me pakicë të teksteve mësimore, doracakëve dhe materialeve arsimore me TVSH, çdo vit merr vendim mbi çmimin më të lartë të shitjes me pakicë të teksteve mësimore, doracakëve dhe materialeve arsimore me TVSH, më së voni deri më 15 mars të vitit vijues për vitin e ardhshëm shkollor.

Komisionin nga paragrafi 1 i këtij neni, i cili ka shtatë anëtarë, nga të cilët tre janë ekspertë nga fusha e botimit (përfaqësuesi i botuesit publik dhe dy përfaqësues të botuesve tjerë), njëri nga Ministria, njëri nga organi kompetent për punët e tregtisë dhe njëri nga organi kompetent për mbrojtjen e konsumatorit dhe eksperti për shkenca ekonomike të cilin e propozon këshilli shoqëroro-ekonomik, e emëron ministri.

Vendimi nga paragrafi 1 i këtij neni shpallet në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë.

Me përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni, në vitin në të cilin shpallet Thirrja publike, vendimi nga paragrafi 1 i këtij neni shpallet më së voni në ditën e shpalljes së Thirrjes publike.

Çmimi më i lartë i shitjes me pakicë të teksteve mësimore, doracakëve dhe materialeve arsimore me TVSH, i cili shtypet në gjuhën e pakicës kombëtare, gjegjësisht me përmbajtje dhe/apo format të përshtatur për nxënësit me pengesa në zhvillim apo invaliditet, nuk mund të jetë më e lartë se çmimi i shitjes me pakicë i teksteve mësimore, doracakëve dhe materialit arsimor me TVSH në gjuhën serbe i cili është i përkthyer, gjegjësisht përmbajtja dhe/apo formati i të cilëve është përshtatur.

Botuesit i ndalohet që tekstin mësimor, doracakun apo materialin arsimor ta shesë me çmim më të lartë se çmimi i caktuar me anë të vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni.

Kriteret për formimin e çmimit më të lartë të shitjes me pakicë të teksteve mësimore, doracakëve dhe materialeve arsimore me TVSH, si dhe mënyra e punës së Komisionit nga paragrafi 1 i këtij neni bashkë i rregullojnë ministri përgjegjës për punët e arsimit dhe ministri përgjegjës për punët e tregtisë.

Monitorimi i teksteve mësimore

Neni 36

Botuesit janë të detyruar që përmes sistemit të brendshëm të kontrollimit të monitorojnë kualitetin e teksteve mësimore të tyre, të marrin mendimin e përdoruesve të teksteve mësimore dhe evidencën mbi monitorimin ta bëjnë publike.

Kualitetin e teksteve mësimore dhe rezultatit e përdorimit në punën arsimoro-edulative e monitoron në mënyrë të vazhdueshme Enti.

VI BOTIMI I TEKSTEVE MËSIMORE

Detyra e botuesit të teksteve mësimore

Neni 37

Ministria, më së voni deri më 30 mars të vitit shkollor në të cilin publikohet Katalogu, ia dorëzon botuesve njoftimin mbi rezultatit e zgjedhjes së teksteve mësimore të cilët mund të përfshihen në Katalog, gjegjësisht brenda afatit prej tri ditëve në rastin nga neni 33 paragrafi 9 i këtij ligji.

Botuesi është i detyruar që brenda afatit prej shtatë ditëve nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi 1 i këtij neni, për secilin tekst mësimor t'ia dorëzojë Ministrisë faturën e zbrazët të evidentuar në regjistrin e faturave të cilin e udhëheq Banka Popullore e Serbisë me afat të fundit maturimit prej katër viteve nga dita e lëshimit, me autorizim faturor në lartësinë e shumës e cila mbulon çmimin prodhues në tirazhit të atij teksti mësimor për një vit shkollor, dhe nëse botuesi në Katalog ka 10 apo më shumë tekste mësimore, e dorëzon faturën e zbrazët me autorizim faturor në lartësi prej 10.000.000,00 dinarëve. Në rast se vjen deri te aktivizimi i faturës, botuesi është i obliguar që brenda afatit prej tetë ditëve nga dita e dërgimit të faturës për pagesë Ministrisë t'ia dërgojë faturën e re të zbrazët solo me autorizim faturor në lartësinë e shumës e cila mbulon çmimin prodhues të tirazhit të atij teksti mësimor për një vit, gjegjësisht shumës prej 10.000.000,00 dinarëve.

Nëse botuesi nuk ia dorëzon Ministrisë faturën, teksti mësimor nuk do të futet në Katalog. Shkollat të cilat kanë zgjedhur tekstin e botuesit i cili nuk e ka dorëzuar faturën do të përdorë tekstin mësimorë të ardhshëm, në pajtim me nenin 33 të këtij ligji, kurse nëse në Katalog, gjegjësisht në Listë nuk ka tekst mësimor tjetër të aprovuar për atë lëndë, Ministria do ta urdhërojë botuesin publik që të përgatitë tekstin i cili mungon dhe të caktojë afatin brenda të cilit është i detyruar që të bëjë kërkesë për aprovimin e atij teksti mësimor.

Obligim i botuesit teksti mësimor i të cili është përfshirë në Katalog, përveç obligimeve të caktuar me anë të rregullave mbi lëshimin e publikacionit, është që të:

- 1) publikojë tekstin mësimor sipas dorëshkrimit i cili është aprovuar;

2) sigurojë tekstet mësimore në numër të mjaftueshëm të ekzemplarëve sipas nevojave të shprehura të shkollave dhe shfrytëzuesve, për katër vitet e ardhshme shkollore nga viti në të cilin është shpallur Katalogu;

3) sigurojë tekstet mësimore në gjuhën e pakicës kombëtare dhe tekstin me përmbajtje dhe/apo format të përshtatur për nxënësit me pengesa në zhvillim apo invaliditet, nëse zgjidhet teksti i atij botuesi, në numër të mjaftueshëm të ekzemplarëve sipas nevojave të shprehura të shkollave dhe shfrytëzuesve, për katër vitet e ardhshme shkollore nga viti në të cilin është publikuar Katalogu;

4) ta bëjë të disponueshëm tekstin për rrjetin shitës, më së voni deri më 15 gusht të vitit vijues për vitin e ardhshëm shkollor;

5) ta bëjë të disponueshëm për rrjetin shitës përkthimin e tekstit mësimor të aprovuar nga gjuha serbe në gjuhën e pakicës kombëtare dhe tekstin mësimor të aprovuar i cili shtypet me përmbajtje dhe/apo format të përshtatur, deri në fillim të vitit të ardhshëm shkollor;

6) ekzemplarin e tekstit mësimor nga Katalogu t'ia dërgojë Entit dhe bibliotekave të enteve të shkollimit të lartë të cilat realizojnë programe studimore për arsimimin e arsimtarëve, më së voni deri më 15 gusht të vitit në të cilin është publikuar teksti mësimor në Katalog;

7) monitorojë kualitetin e teksteve mësimore të veta dhe mendimin e përdoruesve të tyre, si dhe evidencën për atë monitorim ta bëjë publike për secilin vit shkollor, më së voni brenda afatit prej gjashtë muajve nga dita e përfundimit të vitit shkollor;

8) paguajë mjetet në lartësi prej 2% nga të hyrat neto të realizuara nga shitja e teksteve mësimore në vitin paraprak kalendarik më së voni deri më 31 mars të vitit vijues.

Mjetet nga taksa nga paragrafi 4 pika 8) e këtij neni, janë të hyra të buxhetit të Republikës së Serbisë dhe paguhet në llogarinë e rregulluar për pagesën e të hyrave publike, kurse përdoren për qëllimet e caktuara me anë të nenit 9 të këtij ligji.

Si mjet i sigurimit për përmbushjen e detyrave nga paragrafi 4 pika 8) e këtij neni, botuesi më së voni deri më 1 qershor të vitit në të cilin shpallet Katalogu, i dorëzon Ministrisë faturën në lartësi prej 2% nga të hyrat e projektuara neto, të cilat llogariten në bazë të tirazhit i cili paraqet numrin e teksteve mësimore të nevojshme për të gjithë nxënësit të cilët vijnë shkollat të cilat kanë zgjedhur tekstet mësimore të atij botuesi para publikimit të Katalogut, për një vit shkollor.

Obligimet e botuesit nga paragrafi 4 pika 1)-5) e këtij neni kanë të bëjnë edhe me botuesit doracakët dhe materialet arsimore të të cilëve janë përfshirë në Katalogun e doracakëve dhe materialeve arsimore.

Nëse botuesi nuk përmbushë obligimet nga paragrafi 4 pika 1)-5) dhe pika 8) e këtij ligji, Ministria do të aktivizojë faturën, kurse mjetet në cilat thirret fatura do të përdoren për sigurimin e teksteve mësimore, në pajtim me këtë ligj.

Përmbajtja e teksteve mësimore të publikuara në Katalog

Neni 38

Teksti mësimor i cili është publikuar në Katalog, përveç të dhënave të vërtetuara me anë të rregullave mbi shpalljen e publikacionit, përmbanë edhe:

- 1) titullin;
- 2) emrin e lëndës apo lëmisë, klasën dhe llojin e shkollës për të cilën botohet;
- 3) numrin dhe datën e aktit me të cilin është aprovuar dorëshkrimi për botim dhe përdorim në shkollë;
- 4) vërejtjet e posaçme lidhur me botimin dhe përdorimin.

Dispozitat e këtij neni njëjtë aplikohen edhe në doracakët dhe mjetet arsimore, mjetet arsimore shtesë, mjetet arsimore ndihmëse, mjetet didaktike dhe mjetet didaktike për lojë.

Botimi i ri i tekstit mësimor

Neni 39

Botimi i ri i tekstit mësimor i cili shtypet me përmbajtje të pandryshuar, nuk i nënshtrohet aprovimit të përsëritur.

Me ndryshimin e përmbajtjes nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk konsiderohet:

- 1) korrigjimi i gabimeve dhe gabimeve pa dashje në tekst (emrat, titujt, numrat, gabimet drejtshkrimore, ilustrimet e vjetra etj.);
- 2) ndryshimet dhe/apo plotësimet të cilat paraqiten nga nevoja që të bëhet harmonizimi me ndryshimin e rregullave, përveç rregullave të cilat kanë të bëjnë me Standardet, Planin e teksteve mësimore dhe planin dhe programin arsimor;
- 3) ndryshimet dhe/apo plotësimet në bazë të të dhënave zyrtare (të dhënat shkencore, njësitë matëse, shenjat teknike, teknologjike dhe të tjera);
- 4) promovimi i formimit didaktik të teksteve mësimore me të cilat ndryshohet, gjegjësisht plotësohet më së shumti deri 5% e përmbajtjes.

Botuesi më së voni deri më 15 maj të vitit vijues për vitin e ardhshëm shkollor i bën Ministrisë kërkesë për të vërtetuar se botimi i ri i tekstit mësimor përmbanë ndryshime dhe plotësime në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni.

Me kërkesën, botuesi në katër kopje në formë të shtypur dhe elektronike e dorëzon tekstin mësimor të aprovuar, dorëshkrimin e botimit të ri të tekstit mësimor, arsyetimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të tekstit mësimor dhe dëshminë mbi pagesën e taksës.

Ministria, brenda afatit prej 10 ditëve të punës nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafi 3 i këtij neni, i dorëzon Entit në tri kopje tekstin mësimor rreth aprovuar, dorëshkrimin e botimit të ri të tekstit mësimor në formë të shtypur dhe elektronike dhe arsyetimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të tekstit mësimor.

Enti, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës së botuesit, i dorëzon Ministrisë dhe botuesit mendimin profesional të komisionit të cilin e formon nga radhët e të punësuarve, se botimi i ri i tekstit mësimor është ndryshuar në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni dhe se nuk i nënshtrohet aprovimit të përsëritur, gjegjësisht se dorëshkrimi i dorëzuar nuk paraqet botim të ri të tekstit mësimor në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni.

Nëse në Ent nuk janë punësuar personat me arsimim adekuat, mund të angazhohen personat nga Lista e vlerësuesve.

Ministri, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e marrjes së mendimit profesional nga paragrafi 6 i këtij neni merr vendimin, me të cilin vërteton se a paraqet botimi i ri i tekstit mësimor botim i cili shtypet me përmbajtje të pandryshuar.

Botimi paraprak i tekstit mësimor nga paragrafi 2 pika 4) e këtij neni i cili ka botim të ri, mbetet të përdorim.

Vendimi nga paragrafi 8 i këtij neni futet në Katalog.

Dispozitat e këtij neni njëjtë aplikohen edhe në tekstet mësimore të cilat i aprovon Sekretariati Krahinor.

Dispozitat e paragrafit 4-8 të këtij neni njëjtë aplikohen në procedurën e aprovimit të teksteve mësimore nga neni 20 paragrafi 14 - 16 i këtij ligji.

Lartësinë e taksës nga paragrafi 4 i këtij neni e cakton ministri, në propozim të Entit.

Mjetet nga taksa nga paragrafi 4 i këtij neni, janë të hyra të buxhetit të Republikës së Serbisë dhe paguhen në llogarinë e rregulluar për pagesën e të hyrave publike.

VII HEQJA E TEKSTEVE MËSIMORE NGA PËRDORIMI

Neni 40

Teksti mësimor hiqet nga përdorimi në rast se:

- 1) nuk është i publikuar në pajtim me drejtshkrimin e aprovuar;
- 2) nga neni 32 i këtij ligji (shkelja e së drejtës autoriale);
- 3) botuesi nuk siguron tekstin e zgjedhur sipas nevojave të shprehura të shkollave, në pajtim me këtë ligj.

Kërkesën për heqjen e teksteve mësimore mund t'ia bëjë Ministrisë çdo person fizik apo organ shtetëror.

Në rastin e bërjes së kërkesës për heqjen e teksteve mësimore për shkak të arsyes së vërtetuar me anë të paragrafit 1 pika 1) e këtij neni, Ministria merr mendimin e Entit brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e bërjes së kërkesës për heqjen e teksteve mësimore.

Ministri merr vendim mbi heqjen e teksteve mësimore, të cilat janë në procedurë administrative.

Me anë të vendimit nga paragrafi 4 i këtij neni teksti mësimor hiqet nga përdorimi brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e marrjes së vendimit, mbi të cilën Ministria njofton shkollat të cilat përdorin tekstin mësimor të hequr.

Shkollat të cilat kanë përdorur tekstin mësimor i cili është hequr nga përdorimi, janë të detyruara që brenda afatit prej tri ditëve të punës nga dita e marrjes së vendimit nga paragrafi 4 i këtij neni, të zgjedhin tekstin mësimor tjetër nga Katalogu.

Shkolla e njofton Ministrinë mbi vendimin nga paragrafi 6 i këtij neni, mbi të cilën Ministria brenda afatit prej tri ditëve njofton botuesin se cilin tekst mësimor e ka zgjedhur shkolla.

Me përjashtim, nëse në Katalog gjegjësisht në Listë, ekziston vetëm teksti mësimor i cili është hequr nga përdorimi, Ministria do të:

1) në rastin nga paragrafi 1 pika 1) e këtij neni, do ta urdhërojë botuesin që në shpenzimet e veta të botojë tekstin mësimor në pajtim me dorëshkrimin e aprovuar dhe t'i zëvendësojë tekstet mësimore të hequra më së voni brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e marrjes së vendimit, kurse në rastin që botuesi nuk vepron sipas urdhërit, Ministria do të aktivizojë faturën;

2) në rastin nga paragrafi 1 pika 2) e këtij neni do të marrë vendim me të cilin teksti mësimor hiqet në fund të vitit shkollor vijues, kurse në rast se me anë të vendimit gjyqësor ksti mësimor i lëndës të hiqet menjëherë nga përdorimi, Ministria brenda afatit prej tri ditëve nga dita e informimit për ekzistimin e vendimit gjyqësor, do të kërkojë nga botuesi që brenda afatit prej tetë ditëve të paraqesë provë që në bazë të vendimit gjyqësor t'i paguajë dëmshpërblim pronarit të të drejtave autoriale, në të kundërtën Ministria do të aktivizojë faturën me qëllim të pagesës së kompenzimit pronarit të të drejtës autoriale në mënyrë që teksti mësimor të përdoret deri në fund të vitit shkollor;

3) në rastin nga paragrafi 1 pika 3) e këtij neni, do ta urdhërojë botuesin publik që të përgatisë tekstin mësimor i cili mungon, i cili do të financohet me mjetet nga fatura e aktivizuar e botuesit të tekstit mësimor i të cilit është tërhequr.

Teksti mësimor i tërhequr fshihet nga Katalogu dhe Lista.

Dispozitat e këtij neni njëjtë aplikohen në tekstet mësimore të cilat i ka aprovuar Sekretariati Krahinor.

VIII MBIKQYRJA

Neni 41

Mbikqyrjen mbi zbatimin e këtij ligji e bën Ministria, përmes inspektorëve arsimor, në pajtim me ligjin.

IX DISPOZITAT DËNUESE

Neni 42

Me gjobën prej 1.000.000,00 deri 2.000.000,00 dinarë do të dënohet për kundërvajtje botuesi – personi juridik, gjegjësisht ndërmarrësi, me gjobë në shumën prej 250.000,00 deri 500.000,00 dinarë nëse:

1) jep deklaratë të rrejshme nga neni 20 paragrafi 6 pika 9) e këtij ligji;

2) kontakton dhe ndikon në anëtarët e Komisionit gjatë procedurës së dhënies së Vlerësimit profesional (neni 22 paragrafi 13);

- 3) bën donacion, dhuratë apo prezantim nga neni 34 paragrafi 4 i këtij ligji;
- 4) shet tekstin mësimor, doracakun dhe materialin arsimor me çmim i cili është më i lartë se çmimi më i lartë i shitjes me pakicë me TVSH (neni 35 paragrafi 6);
- 5) nuk dorëzon faturën nga neni 37 paragrafi 2 i këtij ligji;
- 6) nuk dorëzon faturën nga neni 37 paragrafi 6 i këtij ligji.

Me gjobë prej 100.000,00 deri 1.000.000,00 dinarë do të dënohet për kundërvajtje botuesi – personi juridik, gjegjësisht ndërmarrësi, me gjobë prej 50.000,00 deri 250.000,00 dinarë nëse:

- 1) nuk ia dorëzon kopjen e tekstit të aprovuar të gjithë administratave shkollore me qëllim të zgjedhjes së tekstit mësimor (neni 16 paragrafi 8);
- 2) shet tekstin mësimor dhe doracakun dhe materialet arsimore, të cilat shtypen në gjuhën e pakicës kombëtare gjegjësisht me përmbajtje dhe/apo format të përshtatur për nxënësit me pengesa në zhvillim dhe invaliditet sipas çmimit më të lartë të shitjes me pakicë, e cila është më e lartë se çmimi me pakicë i teksteve dhe doracakëve dhe materialeve arsimore me TVSH në gjuhën serbe, gjegjësisht përmbajtja dh/ose formati i të cili është përshtatur
- 3) nuk paraqet kopjen e tekstit mësimor Entit dhe bilbiotekave universitare të cilat realizojnë programe studimore për arsimimin e mësimdhënësve (neni 37 paragrafi 4 pika 6);
- 4) nuk monitoron kualitetin e teksteve mësimore dhe nuk e bën publik monitorimin për çdo vit shkollor (neni 37 paragrafi 4 pika 7).

Me gjobë prej 50.000,00 deri 150.000,00 dinarë do të dënohet personi përgjegjës i botuesit – personit juridik për kundërvajtje nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni.

Neni 43

Me gjobë prej 100.000,00 deri 1.000.000,00 dinarë do të dënohet shkolla për kundërvajtje nëse:

- 1) nuk përdorë tekstin mësimor të zgjedhur (neni 17 paragrafi 10);
- 2) përdorë doracakun dhe materialin mësimor i cili nuk gjendet në Katalogun e doracakëve dhe materialeve mësimore (neni 18 paragrafi 7);
- 3) nuk zbaton zgjedhjen e teksteve në pajtim me nenin 33 të këtij ligji;
- 4) ndërmjetëson në shitjen e teksteve mësimore me kompensim (neni 34 paragrafi 2).

Me gjobë prej 200.000,00 deri 1.000.000,00 dinarë do të dënohet për kundërvajtje shkolla, gjegjësisht entit parashkollor, nëse pranon donacion, dhuratë apo prezantim nga neni 34 paragrafi 4 i këtij ligji.

Me gjobë prej 50.000,00 deri 150.000,00 dinarë do të dënohet edhe drejtori, gjegjësisht personi përgjegjës i shkollës për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni.

Me gjobë prej 100.000,00 deri 150.000,00 dinarë do të dënohet edhe drejtori, gjegjësisht personi përgjegjës i shkollës, gjegjësisht entit parashkollor, për kundërvajtje nga paragrafi 2 i këtij neni.

Me gjobë prej 50.000,00 deri 150.000,00 dinarë do të dënohet personi i cili jep Vlerësim profesional të kualitetit, mendim profesional, nëse:

- 1) jep deklaratë të pasaktë apo refuzon të nënshkruajë deklaratën mbi konfliktin e intereseve (neni 21 paragrafi 5 dhe neni 26 paragrafi 1);
- 2) nuk jep Vlerësim profesional në pajtim me nenin 22 të këtij ligji;
- 3) nuk jep mendim profesional, në pajtim me nenin 24 të këtij ligji;
- 4) nuk jep mendim profesional në pajtim me nenin 25 të këtij ligji.

X DISPOZITAT KALIMTARE DHE FINALE

Neni 44

Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji do të merren brenda afatit prej gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përveç:

- 1) aktit nga neni 13 paragrafet 4-7 të këtij ligji të cilët do të merren brenda afatit prej tre muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji;
- 2) aktit nga neni 15 paragrafi 3 i këtij ligji i cili do të merret brenda afatit prej tre muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji;
- 3) aktit nga neni 21 paragrafi 15 i këtij ligji, i cili do të merret brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 45

Procedurat për aprovimin e dorëshkrimit të tekstit mësimor të cilat janë filluar sipas rregullave të cilat kanë vlejtur deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji do të përmbillen sipas rregullave sipas të cilave janë filluar.

Doracakët dhe materialet mësimorë për arsimimin e të rriturve, të përgatitur në kuadër të projektit "Mundësia e dytë – Zhvillimi i sistemit të arsimimit themelor funksional të të rriturve" mbetet në përdorim, janë falas për vijuesit dhe mund të merren në formë elektronike nga ueb faqja zyrtare e Ministrisë.

Shoqata e shkollave të cilat realizojnë programin e arsimimit fillor për të rriturit mund të shtypin doracak dhe material mësimor nga paragrafi 2 i këtij neni.

Doracakët dhe materiali mësimor nga paragrafi 2 i këtij neni mund të financohen në pajtim me vendimin e Qeverisë nga neni 9 i këtij ligji apo nga burimet tjera.

Neni 46

Ministria do të shpallë thirrje publike për zgjedhjen e anëtarëve të Listës së vlerësuesve brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të aktit nënligjor nga neni 21 paragrafi 15 i këtij ligji.

Zgjedhja e anëtarëve të Listës së vlerësuesve do të përmbillet brenda afatit prej tre muajve nga dita e shpalljes së thirrjes publike nga paragrafi 1 i këtij ligji.

Me përjashtim të nenit 21 paragrafi 5 i këtij ligji, në thirrjen publike nga paragrafi 1 i këtij neni mund të lajmërohen edhe personat të cilët janë autorë, të punësuar, të angazhuar apo të lidhur me punë, duke përfshirë edhe format tjera të bashkëpunimit të paguar me botuesin e teksteve mësimore të cilat janë aprovuar sipas rregullave të cilat kan vlejtur deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Personat nga paragrafi 3 i këtij neni nuk mund të jenë autorë, të punësuar, të angazhuar apo të lidhur për nga puna, përfshirë edhe format tjerpërfshirë edhe format tjera të bashkëpunimit të paguar me botuesin e teksteve mësimore pas aplikimit në thirrjen publike nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 47

Thirrja publike për bërjen e kërkesës për aprovimin e teksteve mësimore të cilat do të përdoren me fillim të vitit shkollor 2019/2020. Ministria do të shpallë brenda afatit prej dy viteve nga hyrja në fuqi e akteve nënligjore nga neni 13 paragrafi 4-7 dhe neni 15 paragrafi 3 i këtij ligji.

Thirrjen publike për bërjen e kërkesës për aprovimin e teksteve mësimore, doracakëve dhe materialeve arsimore të cilat mungojnë, Ministria do ta shpallë brenda afatit prej një muaji nga hyrja në fuqi e akteve nënligjore nga neni 13 paragrafi 4-7 dhe neni 15 paragrafi 3 i këtij ligji.

Thirrjen publike për zgjedhjen e teksteve mësimore të cilat do të përdoren për vitin shkollor 2016/2017 deri 2018/2019, Ministria do ta shpallë brenda afatit prej tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Në thirrjen publike nga paragrafi 3 i këtij neni, mund të paraqiten botuesit tekstet e të cilëve janë aprovuar në pajtim me rregullat të cilat kanë vlejtur deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji. Në aplikimin në këtë thirrje publike, botuesit cekin tekstet mësimore të aprovuara me të cilatdo të marrin pjesë në zgjedhje dhe paraqesin deklaratat nga neni 20 paragrafi 6 pika 4)-8) e këtij ligji.

Në procedurën e zgjedhjes, botimit, tërheqjes dhe monitorimit të teksteve mësimore nga paragrafi 4 i këtij neni, aplikohen dispozitat e këtij ligji.

Neni 48

Kërkesa për aprovimin e dorëshkrimit të teksteve mësimore për vitin shkollor 2016/2017 bëhet brenda afatit prej 30 ditëve duke filluar nga 1 shtatori vitit 2015, në pajtim me rregullat të cilat kanë vlejtur deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe nenin 20 paragrafi 19 i këtij ligji.

Neni 49

Ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji pushon të vlejë Ligji mbi tekstet dhe mjetet tjera mësimore ("Gazeta Zyrtare e RS", numër 72/09).

Aktet nënligjore të marra deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji mbeten në fuqi deri në vendosjen e rregullave në bazë të këtij ligji.

Neni 50

Ky ligj hyn në fuqi ditën e 8 nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë".